

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale
ADRESA	https://piranjat.al/politike/kuvendi-injoron-konsultimet-publike-fut-ne-shqyrtim-reforme-n-territoria-i105656
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:00:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 14:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5f25e67897a1fb60de15e315f77512a8cc988be1de68e3b7d0b5037026f55ec3
TEKSTI	7ca9ff0372fe71ef29d3ca25cecf6e6ac84d2a3d16521c9d4e9221355d1cbbd4
PAMJA	19f4e9445c0f2c6b7b8467bb8910c1ca9506b6b7a8c3766e333106a92dd66dd8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	75a784ad3de8b5b8c03bcc63cffc200a79f42e77c4baa5a64c4c16d73a633706
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/75a784ad3de8b5b8c03bcc63cffc200a79f42e77c4baa5a64c4c16d73a633706>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

për akuzat

perqendronemi te problemi yt... Të gjithë ne Do të

është bosi shqiptar i

shqiptar dhe i konsideruar nga SPAK

strukturuar kriminal

ish drejtoreshën e S...

do të bjerë si tigër prej

k&e...

Ja kë po përpiqet të

Shërbime Informativ të Shtetit, Vlorë H...

POLITIKE

Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

Piranjat Përditësimi i fundit 23 Shtator 2026, 16:53



Komisioni për Çështjet Ligjore mori në shqyrtim të mërkurën projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njëjste të qeverisjes vendore” të propozuar nga deputetët socialistë, ndërsa konsultimet publike me komunitetet lokale vijojnë deri në fund të shtatorit.

Ulsi Manja, kryetar i këtij komisioni, refuzoi të hidhte në votim kërkesën e opozitës për të rikthyer procedurën e shqyrtimit dhe depozitimin e nismës me përfshirjen e qëndrimeve që vijnë nga komunitetet lokale.

“Ne do të vijojmë shqyrtimin në parim deri më 29 shtator, kur është afati i përfundimit të konsultimeve nëpër bashki, pastaj pasi të marrim dhe këto qëndrime, e votojmë,” tha ai.

Sipas një kalendari pune të Kuvendit, ku parashikohet votimi në seancë plenare më 8 tetor, socialistët në mënyrë të njëanshme kanë vendosur të avancojnë përpara procedurën parlamentare të nismës, ku propozohet një rikonfigurim i hartës territoriale të vendit me reduktimin e bashkive nga 61 në 46. Opozita kundërshtoi në komision futjen në rend dite të nismës së PS-së, duke pretenduar se nisma ishte dorëzuar në shkelje të dispozitave ligjore dhe kushtetuese duke anashkaluar përfundimin e konsultimeve publike.

“Të kthehet pas dhe të futet në procedurën kushtetuese se s’mund të ecim në shkelje të Kushtetutës,” tha Luciano Boçi, i cili ishte bashkëkryetar i opozitës për komisionin bipartizan për këtë reformë.

“Të mbarojnë dëgjesat, të merret mendimi dhe më pas të vihet këtu,” shtoi ai, duke këmbëngulur se një reformë e njëanshme pa konsensus politik dhe për më tepër pa konsensus qytetar bie ndesh me parashikimet kushtetuese.

Edhe deputeti Oerd Bylykbashi kërkoi që Komisioni i Ligjeve të votonte për kthimin e projektligjit në zyrën e Kryetarit të Kuvendit për t’u përfshirë në nismë edhe qëndrimet e konsultimeve publike.

“Kjo nismë godet themelet e Kushtetutës dhe është detyrim ligjor që të merren parasysh qëndrimi i popullsisë,” tha Bylykbashi, duke akuzuar mazhorancën se ka nisur procedurën në shkelje ligjore dhe se po tenton të anashkalojë qëndrimet e komuniteteve.

Deputetë të tjerë të PD-së sollën në vëmendje që në bashkitë që projekti i PS-së parashikon t’i shkrijë me bashki më të mëdha po bëhen protesta të përditshme kundër nismës dhe vetë këshillat bashkiakë kanë votuar kundër shkrirjes.

Në shenjë revolte, deputetët e opozitës braktisën mbledhjen e komisionit, e cila vijoi me prezantimin e nismës nga Arbjan Mazniku.

Mazniku tha se reduktimi i numrit të bashkive do të siguronte më shumë shërbime për qytetarët.

Që prej fillimit të gushtit në të gjitha bashkitë e vendit, propozimi i PS-së po has kundërshti nga qytetarët gjatë dëgjesave publike. Në disa bashki të vogla ka shkaktuar edhe protesta të përditshme që refuzojnë shkrirjen e njësisë së tyre vendore me një njësi më të madhe.

Sipas projektit, bashkitë Fushë-Arrëz, Klos, Rrogozhinë, Dimal, Poliçan, Patos, Divjakë, Selenicë, Maliq, Këlcyrë, Memaliaj, Libohovë, Cërrik, Belsh dhe Prenjas humbasin statusin si njësi të pavarura të vetëqeverisjes vendore dhe bashkohen me bashkitë fqinje më të mëdha. Konkretisht, Fushë-Arrëzi bashkohet me Pukën, Klosi me Matin, Rrogozhina me Kavajën, Dimali dhe Poliçani me Beratin, Patosi me Fierin, Divjaka me Lushnjën, Selenica me Vlorën, Maliqi me Korçën, Këlcyra me Përmetin, Memaliaj me Tepelenën, Libohova me Gjirokastrën, Cërriku e Belshi me Elbasanin, ndërsa Prenjasi kalon nën varësi të bashkisë Librazhd.

Modeli i propozuar synon të ruajë bashkinë si qendër të organizimit vendor, por ndryshon organizimin e saj të brendshëm nga skema “Bashki–Njësi Administrative” në “Bashki–Qytet–Njësi Administrative”.

Për çdo qytet parashikohet emërimi i një nënkryetari përgjegjës për koordinimin e shërbimeve, ndërsa këshillat bashkiakë do të riorganizohen për të pasqyruar peshën demografike të qyteteve

në bashki

Nga ana tjetër opozita ka dalë me një projekt që propozon shtimin e bashkive nga 61 në 100 njësi për të decentralizuar shërbimet publike më pranë komuniteteve./BIRN

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 23 Shtator16:45

[Blushi kërkesë zyrtare Peleshit, Manjës e Xhafajt: Kuvendi të ndërhyjë për zgjidhjen e konfliktit mes GJKKO dhe Dhomës së Avokatisë](#)

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë së Lirisë, Tedi Blushi, i ka dërguar sot një kërkesë zyrtare Kryetarit të Kuve...

POLITIKE 23 Shtator14:48

[Berisha: Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi takoheshin në lokalin e Jurgen Kolës në Bërzhitë. Është 'ushtari' i saj në SHISH](#)

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka hedhur akuza të forta lidhur me drejtimin e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe ish-drejtuases...

POLITIKE 23 Shtator14:41

[Skandali me Vlora Hysenin, Këlliçi: Siguria kombëtare është e shpartalluar, duhet me urgjencë qeveri teknike dhe zgjedhje të reja](#)

Deputeti i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka reaguar me tone të ashpra lidhur me skandalin e zbuluar me ish-drejtuosen e SHISH, Vl...

POLITIKE 23 Shtator14:35

[Berisha: Kërkojmë dorëheqjen urgjente të Ramës, kjo do jetë çështja kryesore në Kuvend. A e patë se si Gysi bënte...](#)

Kryetari i PD, Sali Berisha deklaroi gjatë mbledhjes së grupit parlamentar demokrat se opozita kërkon dorëheqjen urgjente të kryemini...

POLITIKE 23 Shtator13:12

[A ka folur Mirel Mërtiri? Investigimi nga Austria që paralajmëron zbardhjen e aferës së inceneratorëve](#)

Një dokumentar investigativ që po përgatitet në Austri pritet të sjellë të tjera të dhëna mbi akuza për korrup...

POLITIKE 23 Shtator12:31

[Tërmet në kupolën e sigurisë/ Tabaku në Kuvend: Shteti ka rënë, qeveria i ka dhënë besën krimit!](#)

Deputetja e Partisë Demokratike dhe kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik, Jorida Tabaku, deklaroi se ...

POLITIKE 23 Shtator12:03

[Shkrirja e 15 bashkive, Bozdo nga Komisioni i Ligjeve: Projektligj fals i urdhëruar nga Rama! Dëmtohen komunitetet](#)

Debatet për Reformën e re Territoriale kanë përfshirë mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve, ku deputeti i Partisë...

POLITIKE 23 Shtator11:36

[U denoncua nga Piranjat/ PD kërkon dorëheqjen e ministres së Shëndetësisë, Klodiana Spahiu: Të sqarojë dyshimet për plagjiaturë](#)

Deputeti i Partisë Demokratike, Bardh Spahia, ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, pas dyshi...

POLITIKE 23 Shtator11:05

["Rama është arkitekti, u jep pushtet drejtuesve "/ Ina Zhupa për arrestimin e Vlora Hysenit: Siguria kombëtare në pikëpyetje](#)

Arrestimi i drejtoreshës së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni, ka ngritur shqetësime të forta politike për sigu...

POLITIKE 23 Shtator09:17

[Masa ndaj shefes së SHISH, PD mbledh Kryesinë, Sekretariatit dhe grupin parlamentar](#)

Partia Demokratike do të mbledhë sot pasdite Kryesinë e re, së bashku me Sekretariatit dhe grupin parlamentar. Mbledhja zhvillohet nj&eum...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

[Skandal/ Kreu i SHISH mesazh Agasit: Zemër, duh...](#)

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në di...

[“Balluku kur do arrestohet?” - Gazetari Qyno: K...](#)

Gazetari Elton Qyno ka debatuar mbrëmjen e sotme me juristët në emisionin “Top Story”, lidhur me hetimet e SPAK ndaj ish-zëvend&...

[“Pinte kafe çdo javë me Dumanin”/ Urdhër-arrest...](#)

Gazetari Elton Qyno ka komentuar mbrëmjen e sotme në ‘Top Story’ urdhër-arrestin e SPAK për kreun e SHISH, Vlora Hyseni. Qyno k...

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnamit ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.